



J>P

**”Më i miri prej jush,
më i dobishmi për njerëzit”**

MUHAMEDI (Paqja qoftë mbi të)

KUSH ËSHTË JAP?

JAP-i është bashkim vullnetar, anëtarët e të cilit japin nga koha, aftësitë, përvoja dhe pasuria e tyre për të mirën e përgjithshme. Kjo iniciativë synon që përmes projekteve dhe veprimtarive të tjera të ndikojë dukshëm në përmirësimin e shoqërisë.

“JAP” është një iniciativë unike në Kosovë e një grupi të motivuar vullnetarësh që vijnë nga profile të ndryshme të shoqërisë. Ata, të motivuar nga vlerat e besimit, shprehin vullnetin dhe përkushtimin për të dhënë kontributin e tyre në përmirësimin e shoqërisë në atdheun e tyre.

JAP-i është grup me karakter punues dhe si i tillë është i përirë për të realizuar aktivitete, nisma dhe projekte të ndryshme, si instrumente të përmbushjes së nevojave dhe përmirësimit të shoqërisë.

Ndonëse idetë, mendimet dhe diskutimet janë pjesë përbërëse e anëtarëve dhe e grupit, ato në vetvete konsiderohen si të pamjaftueshme për përmirësim. Veprimet dhe projektet për realizimin e tyre janë veçori dalluese e anëtarëve dhe e grupit JAP.

Anëtarët e JAP-it ndërmarrin iniciativa ose u bashkëngjiten iniciativave, duke dhënë kontributin e tyre personal dhe profesional, të shtyrë nga ndjenja e përgjegjësisë dhe iniciativës individuale. Ata e bëjnë këtë ngaqë janë motivuar nga potenciali që ua ka dhënë Zoti për të përhapur të mirën, por mbi të gjitha për të synuar pozitën dhe shpërbimin më të mirë...

Grupi JAP është njëkohësisht edhe platformë e mjedis i hapur për shkëmbim të ideve, opinioneve, përvojave, përshtypjeve dhe vlerësimeve për projektet dhe fenomenet sociale që ndodhin në shoqërinë tonë.

Grupi ka struktura formale; anëtarësia e tij është e strukturuar në Këshillin Drejtues, si forumi kryesor i diskutimeve dhe organi kryesor i vendimmarrjes, në Sekretariatën si organ kryesor drejtues dhe në komunitetin e vullnetarëve. Aktualisht ka rreth 40 anëtarë në grupin e vullnetarëve, 15 prej të cilëve janë pjesë e Këshillit Drejtues.

Zgjedhja në struktura drejtuese bëhet me parime të barazisë dhe rotacionit. Grupi veprimtarinë e vet e rregullon përmes dokumenteve bazë të nxjerra nga anëtarët për t'iu përshtatur natyrës dhe karakterit të grupit (Statuti, Kodi i Etikës). Grupi funksionon me parime demokratike dhe merr vendime që përfaqësojnë vullnetin e shumicës, përfaqësim që bëhet përmes votimit.

Modeli i punës: Anëtarët e grupit, në baza vullnetare, por me përgjegjësi të lartë, duke funksionuar si koalicion shoqëror, angazhohen në iniciimin ose përmbushjen e projekteve të ndryshme.

Baza mbështetëse e projekteve është kontributi i vetë anëtarëve përmes kryerjes së punëve të ndryshme, si dhe përmes vetëfinancimit nga kontributi i anëtarësisë. Pjesa e çmuar këtu mbështet vullnetarët.

JAP-i është i prirë për rritje dhe zgjerim të vazhdueshëm. Andaj me dëshirën për të qenë qendër gravituese ftojmë të na bashkëngjiten aktivistë, profesionistë, biznesmenë, intelektualë e njerëz të dijes, punëtorë të devotshëm të kauzave fisnike dhe njerëz të vullnetit të mirë që duan ta pranojnë fisnikërinë e të shërbyerit të rregullt me të paktën 4 orë në javë (16 orë në muaj) dhe një kontribut financiar prej 20, 40, 50, 80, 100 a më shumë në baza mujore.

Karakteristikë e grupit janë takimet e përbashkëta, të cilat janë forume të diskutimeve dhe njëherazi janë thelbi i ideve, i projekteve të reja dhe i nxitjes për punë. Këto takime mbahen fizikisht ose në distancë përmes veglave teknologjike. Pjesëmarrja është e detyrueshme për të gjithë anëtarët. Takimet mbahen 1-2 herë në muaj.

Meqë ky grup është grup punues, kërkon sakrificë të kohës, të punës dhe parasë. Ata që nuk kanë mundësi të kontribuojnë në nivele modeste në asnjërën prej tyre, janë të liruar nga grupi dhe kontributin e kohëpaskohshëm mund ta japin në komunitetin e vullnetarëve.

Anëtarët e grupit përpiqen që me punën dhe shembullin e tyre të kontribuojnë në krijimin e një kulture individuale dhe shoqërore, ku njerëzit e frymëzuar nga besimi preokupohen aktivisht dhe angazhohen praktikisht për të realizuar interesa përtej vetes dhe familjes.

Ndërsa nga vullnetarët e grupit JAP pritet një kontribut prej të paktën 30 orëve në vit nëpër projektet ose kampanjat e grupit JAP. Grupi është mjedis ku përfitohet nga ajo që jep dhe ajo që merr, jo vetëm si fryte të punës së drejtpërdrejtë, por edhe si përvoja interesante, si rrjet i njohjes së njerëzve, si mundësi për aftësime të reja dhe si potencial i mirë për bashkëpunim.

Grupi ka zyrat e veta në Prishtinë, të cilat i përdor për nevoja të grupit dhe për projekte që janë pjesë e tij.

PSE U THEMELUA JAP?

> Nevoja për të ruajtur dhe kultivuar unitetin, duke e parë unitetin si të vetmen formë të shtyrjes përpara të interesave tona në mënyrë të qëndrueshme. Me theks të veçantë unitetin e njerëzve me potencial, uniteti i të cilëve kontribuon në unitetin e masave.

> Nevoja për të krijuar një hapësirë pune ku njerëzit e vullnetit të mirë mund të angazhohen për të mirën publike. Ta bëjnë këtë me dinjitet dhe përgjegjësi intelektuale e njerëzore, pavarësisht përgjegjësiwe institucionale, apo kualifikimeve profesionale, por të shtyrë nga ndërgjegjja e gjithsecilit, nga brenga dhe dëshira për të bërë ndryshim pozitiv.

> Nevoja për të faktorizuar një masë të njerëzve me potencial - Aktivizimin e potencialit tonë njerëzor para se të devalvojë.

> Nevoja për të lidhur potencialin njerëzor në një rrjet më të gjerë dhe që projektet të bëhen lehtë të përshkallëzueshme.

SI TË BËHEM JAP?

Anëtarësia në JAP është tri llojesh:

1. Anëtar i rregullt


Anëtari i rregullt dhuron katër orë angazhim në javë dhe së paku njëzet (20) euro në muaj për funksionimin e grupit dhe të projekteve (studentët dhe ata që nuk janë në marrëdhënie pune janë të liruar nga kjo).

2. Anëtar kontribuues

Anëtari kontribuues, në pamundësi për t'u angazhuar me punë, kontribuon së paku me pesëdhjetë (50) euro në muaj për funksionimin e grupit dhe të projekteve.

3. Anëtar vullnetar

Anëtari vullnetar, në pamundësi për t'u angazhuar në mënyrë të rregullt, është i gatshëm të angazhohet kohë pas kohe dhe kontribuon së paku me dhjetë (10) euro në muaj (studentët dhe ata që nuk janë në marrëdhënie pune janë të liruar nga kjo).



PSE TË ANGAZHOHENI NË JAP?

- Besojmë se angazhimi juaj do të llogaritet nga veprat e pëlqyera që sjellin sevape.
- Do të jeni pjesë e rritjes së një organizimi që është i dobishëm për bashkësinë dhe shoqërinë tonë.
- Do të keni mundësi të menaxhoni projekte.
- Do të keni mundësi të zhvilloheni profesionalisht dhe si lider.
- Do të keni mundësi rrjetëzimi me njëri-tjetrin.).


Baza mbështetëse e projekteve është kontributi i vetë anëtarëve përmes kryerjes së punëve të ndryshme, si dhe përmes vetëfinancimit nga kontributi i anëtarësisë. Pjesa e çmuar e kontributit janë vullnetarët.

12 PROJEKTE

3 VITE

- > THIRRJA
- > STREHA JONE
- > PERGJIGJE.NET
- > EKONOMIA ISLAME
- > PZH I XHAMIVE

- > INSTITUTI GERMA
- > LITERATURA ISLAME
- > DHURATA E BAJRAMIT



> PRISHTINA TALKS

> DEKORIS

> HISTORICUM



2022

AHIRETI

PROJEKTET E JAP

Formati i projekteve janë:
"Platforma të hapura publike"

Pronësia e projekteve: **Vakëfe**

"Projektet janë mënyra më e mirë për të dhënë mund, djersë dhe para. Ato janë mënyra më e qartë për të menaxhuar dhe ruajtur mundin e anëtarëve. Projektet mundësojnë që nga kontributet të krijohet një ndikim afatgjatë.

Grupi është themeluar në korrik të 2019 dhe deri më tash ka realizuar:

- * **+70 takime të rregullta pune**
- * **6 punëtori.**
- * **12 projekte që janë në faza të ndryshme të zhvillimit**



- ◆ **3 vite shërbim,**
- ◆ **qindra seanca trajtimesh,**
- ◆ **qindra raste të ndihmuara,**
- ◆ **mbi 1000 artikuj dhe punime që ofrojnë ndihmë për publikun**

TRAJTIMET:

- ◆ Stresi, ankthi dhe depresioni
- ◆ Sfidat familjare (bashkëshortore, prindër- fëmijë ...)
- ◆ Varësia nga alkooli dhe substancat narkotike
- ◆ Vështirësitë në mësimet dhe punë
- ◆ Trajtimi i traumave, krizave dhe fobive
- ◆ Shqetësimet e tjera të shëndetit mendor



STREHA JONË

Për një shoqëri me mendje dhe shpirt të shëndoshë.

Një në katër persona vuan nga vështirësitë mendore, shpirtërore ose sociale!

Streha Jonë është një organizatë e dedikuar për përmirësimin e jetës së njerëzve që përjetojnë vështirësi mendore, shpirtërore ose sociale.

Streha Jonë ndihmon njerëzit duke ofruar një shteg mbështetjeje që jep shpresë dhe mundësi për të krijuar lidhje e aftësi të reja për jetën.

Streha Jonë ofron mbështetje personale, aktivitete në grup, seminare që fuqizojnë njerëzit në menaxhimin e mirëqenies së tyre, si dhe ofron shërbime të konsultimit në distancë.

Për herë të parë po bashkohen në trajtim evidenca shkencore, mbështetja emocionale dhe udhëzimet fetare.

Ndihma juaj është esenciale për të garantuar që këto shërbime të ofrohen sa më gjatë, te sa më shumë njerëz dhe me cilësi sa më të lartë.

Përkrahja juaj është jetike për garantimin e jetëgjatësisë dhe cilësisë së këtyre shërbimeve te një numër i madh njerëzish.

Me programin e saj, Streha Jonë mëton të shndërrohet në një qendër me ndikim sa i përket trajtimit psiko-social në vendin tonë.

”Nëpërmjet ndihmës dhe mbështetjes së Streha Jonë, për herë të parë ndihem e emocionuar për të ardhmen time pas shumë vjetësh.” - Gresa

”Gjendjen time aktuale shpirtërore dhe optimizmin për të ardhmen e fitova nga mbështetja dhe udhëzimet që i mora nga Streha Jonë. Për këtë nuk mund ta falënderoj sa duhet.”
- Artani

DHURATA EBAJRAMIT



- Në 6 organizimet e para,
- ◆ **Mbi 100,000 familje të gëzuara direkt dhe indirekt**
 - ◆ **Projekti më i shtrirë në trojet shqiptare dhe diasporë**
 - ◆ **Një model tërheqës i replikuar dhe i përvetësuar nga shoqëria dhe organizatat e shumta.**



DHURATA E BAJRAMIT

**Për të gjithë njerëzit, sidomos
për fëmijët, dhuratat janë burim
gëzimi dhe përmirësim i
gjendjes psiko-sociale të tyre.**

Dhurata e Bajramit synon ngritjen e cilësisë së festimit dhe madhërimin e festave islame, rrjedhimisht shtimin e dashurisë ndaj besimit. Përmes përjetimit emocional dhe shqisës, forcohet lidhja e fëmijëve me festat islame në një mënyrë të veçantë. Kjo shpie në forcimin e identitetit të tyre fetar. Kultivimi i atmosferës festive ndikon edhe në shtimin e dashurisë dhe solidaritetit brenda familjes dhe shoqërisë.

“Jepni dhurata që të duheni...” (Hadith)

Me pikësynimin për ta bërë dhuratën sa kreative, po aq të lirë, Dhurata e Bajramit ka mbledhur një ekip profesionistësh të zellshëm. Veç kësaj, projekti, si platformë komunitare e hapur, kërkon të grumbullojë vullnetarë që angazhohen në synimet e projektit. Aktiviteti kryesor i tyre është lehtësimi i përgatitjes dhe shpërndarjes së dhuratave për fëmijët e trojeve shqiptare dhe ata të diasporës.

“Gëzimi i fëmijëve është gëzimi i të rriturve.”

Dhuratat mund të porositen në formë individuale ose grupe. Porositë grupe lehtësojnë tejmasë organizimin festiv në nivel komunash..

Realizimi i aktivitetit në mënyrë kaq të organizuar ka pasur tri përparësi:

- > është bërë më mirë
- > është bërë më lirë
- > është promovuar më shumë, me ç'rast, në mënyrë të natyrshme, është krijuar një rrjetëzim mes një komuniteti të gjerë që janë përfshirë në këtë aktivitet.

PRISHTINA Talks



PR Talks 01

“Leadership i suksesshëm”

Prof.Dr.Hfz. Hajredin Hoxha

PR Talks 02

“Misioni i Intelektualit”

Prof. Rudian Zekthi

PR Talks 03

“Nacionalizmi shqiptar në modernitetin osman: figura e Hasan Prishtinës”

Historian Shasivar Kabashi

PR Talks 04

“Obligimet kolektive në pritje”

Dr. Afrim Bulliqi

PR Talks 05

“Xhemijeti, koha, rrethanat, personalitetet, gabimet dhe sukseset”

Publicist Nexhmedin Spahiu

PR Talks 06

“Blockchain dhe perdorimi i tij në menaxhimin e vakëfit”

Phd.Cand. Llokman Hoxha

Për një vit synojmë:

Dhjetëra ligjërime ◆

Dhjetëra ide ◆

Qindra pjesëmarrës e ◆

Mijëra ndjekës ◆



PR Talks 07

“E djathta në botë dhe tek ne, pikëtakimet e vendit tonë me të djathtën”

Fitim Zekthi

PR Talks 08

“Identiteti politik dhe kulturor i kombit shqiptar”

Kim Mehmeti

PRISHTINA TALKS

Prishtina Talks organizon debate, diskutime, forume, konferenca dhe prezente me qëllim të ngritjes së përbashkët të shoqërisë.

Shoqërisë sonë i nevojitet një hapësirë ku shohiten ide dhe koncepte me interes e ndikim shoqëror. Prishtina Talks ofron një hapësirë për të rigjetur potencialet tona, për të zgjeruar horizontet, për ta ndërruar perspektivën dhe për ta zbuluar më tej të mundshmen.

Prishtina Talks mëton të zhvillojë dhe përmirësojë mendimin mbi identitetet dhe konceptet që përcaktojnë orientimin kulturor, zhvillimor dhe fetar të shoqërisë në vendin tonë.

Objektiv i Prishtina Talks është identifikimi dhe përzgjedhja e folësve dhe i temave të duhura. Në sajë të kësaj, synohet promovimi i tematikave risia e të cilave qëndron në mënyrën e perceptimit dhe trajtesës së tyre nga intelektualë të vyer që jo çdoherë e marrin vëmendjen e merituar në spektrin medial shqiptar.

Deri tani, eventet e organizuara në kuadër të projektit kanë tërhequr interesim të lartë. Audienca interaktive ka krijuar diskutime konstruktive, të cilat janë përcjellë te komuniteti i gjerë.

Veç mundësisë për pjesëmarrje fizike në sallë, Prishtina Talks mundëson edhe pjesëmarrje online. Me inçizim profesional të eventeve synohet të krijohet një arkiv i pasur me ligjërata e diskutime që do të jenë të qasshme për të gjithë.

Në afat një vjeçar synojmë: dhjetëra ligjërime, dhjetëra ide, qindra pjesëmarrës e mijëra ndjekës.



- ◆ **5 libra autorialë të përkthyer në gjuhët:**
shqipe, angleze, gjermane, frënge, arabe dhe turke;
- ◆ **10 libra të përkthyer nga gjuhë të ndryshme**



INSTITUTI GERMA

Instituti Germa është institucion kulturor e edukativo-arsimor, i cili merret kryesisht me përkthime, përpilim librash, veprimtari botuese dhe me kurse të gjuhëve të ndryshme.

Instituti Germa synon që, përmes veprimtarisë botuese dhe edukative, të përmbushë nevojat thelbësore për vetëdijësimin e muslimanëve shqiptarë dhe më gjerë mbi vlerat islame në shoqëri.

Misioni ynë është edukimi i brezave të rinj duke ofruar literaturë të përzgjedhur islame për ngritjen e vetëdijes shoqërore mbi vlerat e islamit.

Synimet tona:

Pasurimi i literaturës islame me botime të përzgjedhura që u përgjigjen nevojave thelbësore të shoqërisë.


Kontribuimi në standardizimin e terminologjisë islame në gjuhën shqipe.

Përforcimi i vlerave të mirëfillta në shoqëri.

Edukimi i të rinjve dhe ngritja e tyre intelektuale përmes zhvillimit të aftësive të tyre gjuhësore e shoqërore.



- ◆ **Mbi 6,000 pyetje me përgjigje**
- ◆ **Mbi 300,000 vizita në vit**
- ◆ **Mbi 1,400,000 shfletime**
- ◆ **Mijëra pyetës e pyetje të reja çdo vit**



A lejohet t'i jepet zekati personit që ka nevojë urgjente për para?

Cili është mendimi Islam për martesën e fshehur?

A lejohet Bitcoin në Islam dhe cilat janë qendrimet në lidhje me të?

Një kontribut i vogël nga ti, zgjidhje problemi për dikë tjetër.

PERGJIGJE.NET

Që çdo pyetje të marrë përgjigje, e çdo kureshtje të shuhet.

Jetojmë në kohën kur çdo gjë kërkohet shpejt. Shpejt marrim vendime dhe shpejt biem në mëkate. Platforma Përgjigje përkitazi me këtë mundëson qasje të lehtë e të shpejtë në udhëzimet fetare për çështje të ndryshme, në mënyrë që njerëzit të ruhen nga mëkatet, të çlirohen nga brengat dhe të kenë orientimin e duhur.

Përgjigje është platformë e hapur që synon ta ndihmojë lexuesin shqiptar të kuptojë qëndrimet dhe përgjigjet që jep islami për jetën, punën, zhvillimin, problemet, paqartësitë, si dhe për kuriozitetin i cili buron nga motivi për t'i kuptuar mësimet e Zotit për situatat që lexuesi i ka para vetes.

Përgjigje.net ka grumbulluar dhe sistemuar përgjigjet që kanë dhënë hoxhallarët shqiptarë ndër vite dhe përkthimet e gjykimeve të dijetarëve botërorë në gjuhën shqipe, si dhe shton përgjigje të reja sipas kohës dhe nevojës. Veç kësaj, Përgjigje pranon pyetje të reja me anë të mekanizmave të komunikimit direkt lexues-administrator-hoxhë, përmes formave për dërgimin e pyetjeve (rrjetet sociale dhe adresa elektronike). Kategorizimi i përpiktë i pyetjeve e shpie lehtësisht lexuesin mu te përgjigjet që i interesojnë atij.

Për hoxhallarët dhe studiuesit e fesë, Përgjigje është vegël e vlefshme për të parë zhvillimin e qëndrimeve fetare në ambientin shqiptar.




**Nisma për zhvillimin
E PREDIKUESVE- THIRRËSVE**



- ◆ **Mbi 1200 punime**
- ◆ **Dhjetëra botime**
*në shërbim të thirrësve,
thirrjes dhe institucioneve.*

**Provoje,
vlerësoje,
përmirësoje,
shpërndaje,
merr pjesë,
ndihmoje!**



THIRRJA.ORG

Nisma Thirrja.org është një platformë e hapur publike që ka synim avancimin e thirrjes islame dhe shërbimit fetar, me objektiv kryesor përmirësimin e cilësisë së adhurimit dhe jetës së komunitetit musliman.

Platforma synon ta përmirësojë raportin dhe shërbimin e ndërsjellë mes xhamisë si institucion, predikuesve dhe xhematit.

Kjo platformë vullnetare ofron materiale ndihmuese në zhvillimin e thirrësve, imamëve dhe institucioneve fetare për të gjitha dimensionet që i prekin ata në jetën dhe shërbimin e tyre. Platforma funksionon duke mobilizuar vullnetarë profesionistë që hulumtojnë, përzgjedhin, përkthejnë dhe përgatitin materiale nga autorë e institucione prej më të spikaturave në botë dhe i bëjnë ato të gatshme për qasje të lirë për komunitetin shqiptar.

Platforma kërkon të ndërtojë dialog dhe hapësirë për vlerësim të përbashkët të punës së thirrjes, thirrësve dhe institucioneve nga komuniteti i tyre. Dialogu dhe angazhimi aktiv e i rregullt i të gjitha palëve është garancia e vetme e vlerësimit të drejtë të palëve mes vete dhe e progresit të përbashkët.

Vizioni ynë është krijimi i një komuniteti që përfaqëson shëmbëlltyrën më të lartë të njerëzve në trojet tona, të cilët jetojnë në lumturinë e kësaj bote gjersa synojnë lumturinë e amshimit.



- ◆ **Rreth 1000 tituj**
- ◆ **50,000 vizita vjetore**
- ◆ **1,000,000 shfletime**

- ◆ **Burim i pashtershëm i dijes dhe informatave në kohën e masovizimit të informacionit**
- ◆ **Vegël e nevojshme për çdo intelektual për formim dhe hulumtim.**

Nëse do t'i botonim fizikisht 1000 tituj, me tirazh prej 1000 copë/titull dhe me kosto prej 1€/njësi, do të kapte vlerën 1,000,000€. Ndërsa online kjo arrihet me 1% të këtij buxheti, me efekt edhe më të madh.



LITERATURA ISLAME

Sot teknologjia ka prekur çdo segment të jetës, edhe librin. Me digjitalizimin e tij është lehtësuar bartja e një biblioteke të tërë, me mijëra tituj, në një xhep të xhaketës. Librat islamë kanë lundruar në internet sa andej – sa këtej, derisa të gjithë u përbashkuan në një vend: Literatura Islame.

“Libri arrihet më lehtë se në raftin e shtëpisë.”

Literatura Islame është platformë e hapur publike që mundëson qasje në libra të fesë islame dhe ka për qëllim shpërndarjen e dijeve të islamit përmes librit.

Si më e madhja bibliotekë elektronike në gjuhën shqipe, Literatura Islame i mundëson lexuesit shqiptar t'i qaset literaturës islame në çdo kohë dhe në çdo vend – krejtësisht falas. Platforma u shërben të gjithëve, nga lexuesi më i thjeshtë deri te studiuesi më i zellshëm. Kështu krijohet mundësia për edukim të përgjithshëm, si dhe për hulumtim specifik të temave përmes një profilizimi dhe kategorizimi të avancuar të titujve.

Admiruesit e librit, përveç leximit, mund të bëjnë edhe shpërndarjen dhe shkarkimin e librave. Kjo platformë tejkalon numrin e lexuesve që zakonisht e kufizon tirazhi i librit të shtypur dhe synon të arrijë miliona shqiptarë.

Misioni i Literaturës Islame është ngritja e vazhdueshme e kulturës së leximit e cila do të ngrinte edhe nivelin intelektual të xhemitit. Rikthimi i peshës së librit në botën intelektuale dhe akademike të shoqërive tona është domosdoshmëri.

Vizioni i projektit është transformimi i shoqërisë duke i bërë ata më lexues, më të ditur.



Ekonomia-Islame




Ekonomia Islame është një projekt i përbashkët dhe mënyra për të kontribuar është e ndryshme. Ta rrisim dhe ta bëjmë magazinën më të rëndësime për jetën profesionale në vendet tona.

6000 publikime
qindra artikuj të rinj për çdo muaj
mijëra lexues

Reklamimi përmes
El krijon përfitim të
dyfishtë,
promovon biznesin
tuej dhe shtyn
përpara misionin
fisnik të
magazinës.

NA VIZITO
ekonomiaislame.com



EKONOMIA ISLAME

Një portal që bën publikime të rregullta të artikujve me interes për biznesin dhe ekonominë.

Rubrikat e portalit i kushtohen bizneseve, menaxherëve, hoxhallarëve, punëtorëve, studentëve, institucioneve arsimore, konsumatorëve dhe organizatave të tjera publike, vendore e ndërkombëtare.

Projekti Ekonomia Islame synon që, në edukimin mbi ndërmarrësinë, funksionimin e ekonomisë dhe financave, të përbrendësohen vlerat dhe parimet e ekonomisë islame dhe ndërveprimit të tyre me praktika të shëndetshme. Si rrjedhojë vijnë përfitime të shtuara për shoqërinë tonë dhe njerëzimin.

Ekonomia Islame kërkon të rritë aktivitetin ekonomik të besimtarëve që identifikohen me vlera dhe praktika islame, t'i rritë kapacitetet e bizneseve ekzistuese nga ky komunitet dhe të aktivizojë në treg pjesën joaktive, duke shërbyer si udhëzues dhe motivues për ta.

Veprimtaria publicistike e shumëllojshme synon të krijojë kulturë të leximit dhe ekonomi të mbështetur në dije dhe në praktikat më të mira, duke kombinuar teoritë bashkëkohore të botës islame dhe ato perëndimore. Çaku përfundimtar është ndërmarrësi e aftë, konkurruese dhe me ndikim më pozitiv në shoqëri.

Mision mbetet përpjekja e palodhshme për krijimin e një ekosistemi më të mirë për afarizmin, i cili sjell mundësi dhe shanse për të gjithë e veçanërisht për besimtarët, duke i bërë ata kontribues ekonomikë në shoqëri, për ta rritur ekonominë vendore, sigurinë ekonomike, produktivitetin në nivel të punëtorit dhe biznesit dhe për të arritur përmbushje më të madhe materiale dhe shpirtërore.

Objektiv ka qenë dhe mbetet promovimi i tregut financiar që funksionon brenda kornizës islame, institucioneve financiare bankare, jobankare, sigurimeve, shërbimeve dhe produkteve që ofrojnë këto institucione dhe rregullatives islame për to. Kuptimi i shëndoshë çon në një ekosistem të shëndoshë dhe i rrit mundësitë e mëtutjeshme.



Blog and Podcast



Platforma Historicum qëllim kryesor ka vetëm të vërtetën objektive mbi ngjarjet e kaluara historike me një qasje shumëdisiplinore.



HISTORICUM

Kjo platformë paraqet një vështrim ndryshe mbi tematikat historike me një këndvështrim kritik dhe analitik.

Karakter i shkrimeve

Shkrimet janë kryesisht të fokusuara mbi fushën e studimeve sociale, duke përfshirë ato historike, sociologjike, psikologjike, filozofike, antropologjike etj. Deri më tani shkrimet kanë qenë më shumë të fokusuara në tematikat historike mbi periudhën e vonë osmane.

Videot e podcast-it planifikohen të jenë të transkriptuara dhe të qasshme edhe për lexuesit e faqes historicum.co.

Planet e Historicum

Duke i parë ndryshimet socio-kulturore si në rrafshin global ashtu edhe atë kombëtar, si pasojë e zhvillimit të hovshëm teknologjik, si dhe duke i analizuar trendet dhe nevojën urgjente të kohës për një qasje ndryshe mbi të kaluarën historike, platforma Historicum do të zgjerohet edhe me një seri podcast, e cila do të përfshijë një amalgamë tematikash historike, sociologjike, socio-politike etj. Podcast-i Historicum do të jetë seria që planifikohet të përmbajë me sa vijon:

- > analizë kritike/komentim të librave të shek. XIX-XX;
- > analizë kritike/komentim të gazetave të shek. XIX-XX;
- > analizë sociologjike të dokumenteve origjinale osmane të shek. XIX-XX;
- > prezantim biografik të personazheve historike të periudhës së vonë osmane;
- > seri prezantimesh me studimet e osmanologëve eminentë botërorë;
- > seri të copëzuar nga historia e Evropës;
- > analizë kritike mbi historiografinë klasike dhe moderne islame;
- > analizë socio-kulturore të këngëve folklorike shqiptare të shek. XIX-XX.



“Shumica e gjësendeve shtëpiake
të cilat hudhen janë në gjendje të mirë dhe mund
të ripërdoren.”

MERR & FAL

A keni dashur ndonjëherë të largoni gjësende nga shtëpia juaj të cilat s'ju janë nevojitur më, por nga pamundësia për t'ia dhuruar dikujt, i keni vendosur në një skaj të shtëpisë, ose i keni hudhur në mbeturina? Këtë telashe synon ta zgjidhë projekti Merr & Fal.

Merr & Fal është platformë ku individë mund t'i dhurojnë gjësendet që nuk i nevojiten, po kështu edhe të marrë falas gjëra që të tjerëve nuk u hyjnë në përdorim. Platforma është krijuar me qëllim të ndërmjetësimit mes dhuruesit dhe pranuesit, duke lehtësuar kontaktin mes tyre.

Merr & Fal synon të kultivojë në shoqëri shprehinë e ripërdorimit të gjërave të vlefshme dhe t'i mbajë ato larg nga deponitë e mbeturinave. Misioni është të krijohet një lëvizje popullore që zvogëlon shpërdorimin, çmon vlerën e gjërave, gjersa anëtarët e shoqërisë përfitojnë nga fuqia e komunitetit të gjerë.

Për të realizuar këtë, Merr & Fal ka nevojë për mbështetjen tuaj financiare dhe vullnetare, veçanërisht në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të uebfages, ndërtimin e aplikacioneve mobile, promovimin e platformës në rrjete sociale, në mënyrë që të gjejë përdorim sa më të gjerë në shoqëri.

Decoris



Me Decoris,
organizimi festiv i muslimanëve,
arrin nivel edhe më të lartë.

DECORIS

Decoris është ndërmarrje start-up që dizajnon, prodhon dhe bën distribuimin e produkteve dekorative dhe festive me motive islame, me qëllim që festat tona të përjetohen më këndshëm dhe identiteti ynë të jetë më i fortë.

Shumëllojshmëria e produkteve Decoris mundëson përfshirje të të gjitha grupmoshave dhe dekoret mund të gjejnë vend në shtëpi, ambiente të brendshme e të jashtme, sheshe, rrugë dhe hapësira publike.

Decoris synon të marrë përsipër obligimet kolektive të proceseve, nga dizajnimi i produkteve e deri tek arritja e tyre në treg, me qëllim që këto produkte të ofrohen sa më lehtë, me zgjedhje të bollshme dhe me çmim më të përballueshëm sesa çfarëdo zgjidhje individuale që mund të ofrojë ndonjë subjekt.

Kjo ndërmarrje do të grumbullojë dizajnerë të produkteve, arkitektë, artistë, historianë të artit, etnologë, antropologë, dekorues, menaxherë të eventeve, menaxherë të produkteve dhe ndërmarrës me kompetencë në prodhim, eksport, import dhe distribuim.

Meqë projekti gjendet në fazën start-up, nevojitet mbështetje me burime njerëzore e financiare. Mbështetja financiare mund të jetë donacion, investim vakëf ose parapagim i hershëm i produkteve.

Duke qenë se është startup dhe vakëf, ka nevojë për mbështetje të madhe me resurse njerëzore dhe financiare. Mbështetja financiare mund të jetë donacion, investim vakëf, parapagim i hershëm i produkteve, apo edhe mbështetje në mënyra tjera.



**“Thuaj: Punoni,
se Allahu, i Dërguari i Tij
dhe besimtarët do të shohin punën tuaj.
Së shpejti do të ktheheni tek Ai që di të dukshmen
dhe të padukshmen e Ai do t’ju njoftojë
për atë që keni bërë.”“**



(et-Tevbe, 105)

J>P

jap-i.com
Rr. Shaip Spahia
Mahalla e Muhaxherëve
Prishtinë

